



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR ZBATIMIN E STANDARDIT EVROPIAN TË EKSELENCËS NË QEVERISJEN (ELOGE) NË KOSOVË

Neni 1

Përbërja

Formohet grupi punues për zbatimin e standardit evropian të ekselencës në qeverisjen (ELOGE) në Kosovë, (në vazhdim të tekstit grupi punues), në përbërje si vijon:

1. Imri Semetishti, Koordinator i grupit punues
2. Shemsi Azemi, anëtar
3. Bukuriye Zejnullahu, anëtare
4. Linda Shahini, anëtare
5. Safet Krasniqi, anëtar
6. Xhevahire Zeqiri, anëtare
7. Visar Kozhani, anëtar
8. Behar Krasniqi, anëtar
9. Islam Kaleshi, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

1. Grupi punues ka detyrë dhe përgjegjësi që të zbatojë standardin evropian të ekselencës në qeverisjen (ELOGE) në Kosovë përkatësisht përmbushjen e 12 parimeve të inovacionit dhe qeverisjes së mire demokratike me qëllim të marrjes së çmimit evropian të ekselencës në Qeverisjen (ELOGE).
2. Grupi punues do të udhëhiqet nga Koordinator i lartëcekur dhe secili anëtar do ti ketë fushat përkatëse të cilat do ti caktohen nga koordinatori i grupit punues.
3. Afati i fundit për dorëzimin e standardit të plotësuar është data **31 korrik 2022**.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Koordinatorin dhe anëtarët e grupit punues.


1Nr. 01-020/02-29199

Lipjan, më 06.06.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Formohet komisioni për shqyrtimin e kërkesës së Avdi Ollurit nga Krojmiri Nr.1-400/01-28842 të datës 03.06.2022, në këtë përbërje:

1. Labinot Dedushi, Drejtorati për Infrastruktur, kryesues
2. Valzim Mziu, Drejtorati për Infrastruktur, anëtar
3. Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar

II. Komisioni ka për detyrë të dalë në teren përkatesisht në fshatin Krojmir dhe sipas kërkesës Avdi Ollurit Nr.1-400/01-28842 të datës 03.06.2022 të shqyrtoj dhe verifikoj pretendimet e dëmëve të shkaktuara të palës në fjalë gjatë punimeve lidhur me projektin e Komunës për asfaltimin e rrugës "Rahman Veseli" në fshatin Kromir.

III. Komisioni pas kryerjes së detyrave të cekura në pikën II duhet të hartoj raport me shkrim të cilin do ti a dërgoj Kryetarit të Komunës dhe Drejtorit të Drejtoratit për Infrastruktur.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Infrastruktur, Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

1Nr.400/01-28842
Lipjan, më 09.06.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E ZYRTARES PËRGJEGJËSE**

Neni 1

Me këtë Vendim nënpunësja civile, Bukuriye Zejnullahu-Jashari Shefe e Sektorit për Mardhënie me Publikun, **CAKTOHET** Zyrtare Përgjegjës për menaxhimin me Platformën e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

E lartë cekura do të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Neni 3

1. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Bukuriye Zejnullahu-Jashari Shefe e Sektorit për Mardhënie me Publikun.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.112-8260 i datës 10.02.2020.

1Nr. 112/02-30571
Lipjan, më 14.06.2022

KRYETARI I KOMUNES
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM
MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT- PLANIN KOMUNAL TË VEPRIMIT
PËR TË ZHVENDOSURIT DHE ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME 2022-2025

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2022-2025.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë draft-Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2022-2025 ose në email adresën Zoran.Stanojevic@rks-gov.net më së largu me datë 15.07.2022.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 01-016/01-30979
Lipjan, më 15.06.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Pranuar me Prilijeno: 15.06.2022		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-354/03-30954		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT-RREGULLOREN PËR VENDOSJEN, LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PÛRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Projekt-Rregullorja për vendosjen , ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt-Rregullore mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Projekt-Rregullores për vendosjen , ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohëshme në pronën publike ose në email adresën rafete.retkoceri@rks-gov.net më së largu me datë 15.07.2022.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 1-354/03-30954


Lipjan, më 15.06.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

1287





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR PLOTËSIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE PËR DHËNEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË LOKALEVE AFARISTE DHE ZYREVE NË PRONËSI TË KOMUNËS

I.Me këtë Vendim, ndryshohet neni 1 i Vendimit për formimin e komisionit për monitorimin e zbatimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste dhe zyreve në pronësi të komunës 1Nr.1-361/03-27711 i datës 30.05.2022, dhe përfaqësisht i shtohet edhe një anëtar me numer rendor 4 si në vijim:

1. Gafurr Hetemi, Kryesues i komisionit,
2. Fatbardha Shurdhiqi, anëtare e komisionit,
3. Merita Zeqiri, anëtare e komisionit,
4. Bedri Hetemi, anëtar i komisionit.

II. Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë të përcaktuara në Vendimin për formimin e komisionit për monitorimin e zbatimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste dhe zyreve në pronësi të komunës 1Nr.1-361/03-27711 i datës 30.05.2022.

III.Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Vendimi i dërgohet:
Kryesuesit dhe anëtarëve të komisionit

1Nr.1-361/03-27711/2
Lipjan, 16.06.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
SKUPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.350/05-21269 të datës 26.04.2022 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL

Grupi Punues për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031 themelohet në përbërje prej përfaqësuesve të drejtorateve sektoriale të Komunës së Lipjanit dhe nga përfaqësuesit e kompanive publike.

I. Përfaqësuesit nga Drejtoratet komunale:

1.	Imri Semetishti	Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
2.	Rasim Hasani	Drejtorati për Arsim
3.	Anila Reqica	Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport
4.	Shkelzen Hajdini	Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
5.	Sead Aliu	Drejtorati për Infrastrukturë
6.	Rexhep Rexhepi	Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari
7.	Valon Pacolli	Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim
8.	Vlora Krasniqi	Zyra e Kryetarit – Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore,

II. Përfaqësuesit nga kompanitë publike:

1.	Ilmi Publica	KUR "Prishtina" – NJOU Lipjan
2.	Xhelal Krasniqi	KRM "Pastrimi" - Lipjan

III. Detyrat themelore dhe përgjegjësitë e Grupit Punues

Grupi Punues i kryen detyrat themelore sipas Programit për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031.

Kryerja e detyrave të caktuara nga Grupi Punues bëhet që nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi dhe deri në miratimin e PZHK në Kuvendin e Komunës.

IV. Detyrat e Kryesuesit të Grupit Punues

Në bazë të nenit 54 të Statutit të Komunës, Përfaqësuesi i Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit është Kryesues i Grupit Punues dhe bartës i projektit – PZHK 2023-2031.

Kryesuesi i Grupit Punues, i koordinon të gjitha aktivitetet në kuadër të detyrave të përcaktuara për Grupin Punues të themeluar me këtë Vendim dhe të Grupit Këshillëdhënës nga Komuniteti i themeluar me akt të veçantë.

V. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.


Me këtë Vendim njoftohen të emëruarit në Grupin Punues.

Nr. 1-020/04-31814

Lipjan, më 20.06.2022

Imri AHMETI

Kryetar i Komunës





Në bazë të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110 -78095 të datës 24.12.2021, dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.350/05-21269 të datës 26.04.2022 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E GRUPIT KËSHILLËDHËNËS NGA KOMUNITETI

Grupi Këshillëdhënës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031 themelohet nga përfaqësuesit e kategorive të caktuara të komunitetit në përbërje prej:

I. Përfaqësuesit prej Zonave Rajonale të Komunës:

1.	Besim Azemi	Administrator, Zona – Lipjani 1
2.	Gëzim Bytyqi	Administrator, Zona – Lipjani 2
3.	Mustafë Rexhepi	Administrator i fshatit, Zona – Gadime e Epërme
4.	Fatlum Luma	Administrator i fshatit, Zona – Kraishtë
5.	Milaim Meta	Administrator i fshatit, Zona – Magure
6.	Shefqet Amërlahu	Administrator i fshatit, Zona – Shalë
7.	Skender Gashi	Administrator i fshatit, Zona – Dobrajë e Madhe
8.	Behxhet Konxheli	Administrator i fshatit, Zona – Sllovi

II. Përfaqësuesit nga shoqëria civile:

1.	Ronita Bahtiri	OJQ “Vizioni Rinor”
2.	Leotrim Pajaziti	OJQ “Vizioni Rinor” - Shalë”

III. Përfaqësuesit nga komuniteti i biznesit:

1.	Shqiprim Ahmeti	Kolegji UBT
2.	Faton Gërxhaliu	Komuniteti i Biznesit – Lipjan
3.	Feriz Hasani	Komuniteti i Biznesit – Lipjan

IV. Përfaqësuesit e bashkësive fetare:

1.	Zaim Baftiu	Bashkësia Islame
2.	Mateo Palic	Kisha Katolike
3.	Paroh Dragisa Jernic	Kisha Ortodokse

V. Detyrat themelore dhe përgjegjësitë e Grupit Këshillëdhënës:

- Të marrin pjesë në takimet konsultative dhe në takimet tjera ku prezantohen zhvillimet e Planit Zhvillimor Komunal dhe kur organizohen debatet publike.
- Të kontribuojnë aktivisht në debate me këshillat e tyre për të gjitha çështjet relevante për Planin Zhvillimor Komunal.
- Të përcjellin informatat rreth zhvillimeve për Planin Zhvillimor Komunal te komuniteti i tyre.

VI. Për informim:

Takimet e Grupit Këshillëdhënës ftohen dhe organizohen nga Kryesuesi i Grupit Punues për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023 – 2031.

Duke pasur parasysh interesin publik për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, anëtarët e Grupit Këshillëdhënës dhe anëtarët e grupeve të tjera punuese nuk kompensohen financiarisht për angazhimet e tyre.

VII. Hyrja në fuqi:

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Me këtë Vendim njoftohen të emëruarit në Grupin Këshillëdhënës dhe anëtarët e Grupit Punues për Hartimin e PZHK.

Nr. 1-020/04-31809

Më 20.06.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare 15Nr.400-78035 të datës 24.12.2021 duke u bazuar në Marrëveshjen së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:


**VENDIM
PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS DHE TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

- I. OBLIGOHET**, Drejtorati për Buxhet dhe Financa të bëjë ekzekutimin e pagesës në shumë prej **14,690.00** (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë euro) konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare Nr.15-400-78035 të datës 24.12.2021 dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020 për zbatimin e Projektit **“Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës** i financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe zbatuar nga IADK që shtrihet në komunat Vushtrri, Skenderaj, Lipjan, Shtime, Viti dhe Kamenicë.
- II.** Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural mban përgjegjësinë ,do të kujdeset dhe do të kërkoj nga Organizata IADK raport përfundimtar dhe dëshmi për zhvillimin dhe përfundimin e aktiviteteve të parapara konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020.
- III.** Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet –transferohet në xhirollogarinë bankare të IADK-së nr. 2027000021712884 në TEB Bankë, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2022.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti i dërgohet për zbatim Drejtoratit për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/01-32153
Lipjan, më 21.06.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF - Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në kërkesën e DKA –së të datës Nr.01-020/04-31770 të datës 20.06.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1 Përbërja e Komisionit

Formohet komisioni për përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e prodhimeve bimore të grurit në përbërje si vijon:

1. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsim, Kryesues,
2. Arben Bahtiri, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar

Neni 2 Detyrat e Komisionit

- 1.Detyrë e Komisionit është që të përcaktojë çmimin fillestar për shitjen e grurit në parcelat në pronësi të shkollës "Adem Gllavica" në Lipjan, duke u bazuar në Kërkesën e DKA të Nr.01-020/04-31770 të datës 20.06.2021.
- 2.Komisioni detyrën e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi do ta kryejë më së largu brenda afatit 8 ditor nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.


1Nr.020/04-31770
Lipjan, më 22.06.2022.

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT- RREGULLORE
PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE
MIRËMBAJTJEN E TYRE

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Projekt-Rregullorja për Varrezat, Ofrimin e Shërbimeve të Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt-Rregullore mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Projekt-Rregullores për Varrezat, Ofrimin e Shërbimeve të Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre ose në email adresën rafete.retkoceri@rks-gov.net më së largu me datë 25.07.2022.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 352-32664
Lipjan, më 23.06.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për projektet të OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Selmon Jashanica, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
3. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Shkelqim Bahtiri, nga OJQ-të, anëtar
5. Majlinda Krasniqi, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertës, anëtare
6. Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare rezerv

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për OJQ që veprojnë në Komunën e Lipjanit, që kanë aplikuar konform Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-20303 të datës 20.04.2022, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-32831

Lipjan, më 24.06.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neni 18 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr 06/L-114, neni 7 të Rregullores nr. 12/2020 për orarin të punës dhe pushimet e zyrtarve publikë si dhe neneve 40 dhe 41 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM
PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS PËR SEKTORIN E GJENDJES CIVILE

Neni 1

1. Me këtë Vendim përcaktohet zgjatja e orarit të punës për Sektorin e gjendjes Civile i cili funksionon në kuadër të Drejtoratit për Administratë në Komunën e Lipjanit.
2. Sektori i gjendjes Civile për periodën prej datës 28.06.2022 e deri me datën 31.08.2022, do të punojë çdo ditë pune me palë nga ora 08:00 deri 16:00 si dhe gjatë ditës së shtunë prej orës 9:00 deri në 15:00.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Administratë.

Arsyetim

Zgjatja e orarit të punës bëhet për shkak të numrit të madh të kërkesave që parashtrohen në këtë Sektor që ndërlidhet me fluksin e ardhjes së mërgimtarëve nga shtetet e ndryshme të botës, të cilët e kanë të nevojshme rregullimin e dokumentacionit.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
Drejtoratit për Administratë
Sektorit të Gjendjes Civile
Sektorit për Personel

1Nr. 130/05-33499
Lipjan, më 28.06.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

